



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2826/2 prot.,

Datë 16.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82665-10-06-2023, me objekt: “*Prodhim, publikim, dhe botim i materialeve për fushata promovionale*” me fond limit 1,684,360. Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me Nipt. L52122014L
Adresa: Rr.Siri Kodra, Ish blloku i magazinave, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F me Nipt L36702001T. *Adresa: Rr. Gjovalin Gjadri, zona kadastrale nr.8593, nr.pasurie 13/264, Shkodër.*

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3607, datë 15.11.2023, dhe me nr. 2826/2023 prot., datë 15.11.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-82665-10-06-2023, me objekt: “*Prodhim, publikim, dhe botim i materialeve për fushata promovionale*” me fond limit 1,684,360. Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK si edhe me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F. nga procedura e prokurimit të sipërcituar,

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar”.

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

1-Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyet e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, kundërshton në ankesën e ardhur, si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“-Nga shqyrtimi i mostrave të tenderit të paraqitura nga ana juaj rezulton se ato nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara nga AK në dokumentat e tenderit si më poshtë:

1-Roll – up i kerkuar nga Drejtoria e Sherbimeve Sociale ,Strehimit dhe Shendetit Publik duhet të jete me dimensione 1 x 2.2 m ndersa Roll – up i paraqitur nga ana juaj eshte me dimensionet 87cmx2.2m. Baneri i paraqitur ne Roll – up eshte shume i holle dhe nuk ploteson kerkesat e kerkuara ne specifikime teknike.

2-Guida turistike e kerkuar nga Drejtoria e Rurizmit duhet të kete nje nr. minimal faqesh 130 ndersa guida e paraqitur nga ana juaj eshte me pak se 130 faqe.

3-Baneri i kerkuar nga Drejtoria e Kultures,Arsimit ,Rinise dhe Sporteve eshte kerkuar te jete me përçina me mundësi për kapje me fasheta ndersa i vetmi baner i paraqitur nga ana juaj qe eshte baneri pjese e Roll – up dhe nuk i ploteson keto specifikime teknike.

-Nga verifikimi i shtojces nr.9 Formulari Permbledhes i Vetdeklarimit te paraqitur nga ana juaj rezulton se keni bere deklarim te pasakte ne lidhje me piken ku thuhet:

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, pasi keni deklaruar Autoritetin ose organin lëshues eshte Inpress shpk dhe lloji Lloji i dokumentit: VETEDEKLARIM nderkohe qe organi qe leshon kete dokument eshte Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve dhe lloji i dokumentit eshte Vertetim i Gjendjes Gjyqesore.”

2- Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit “Lulzim Mehmetaj” P.F si më poshtë:

Shtojca 8

1-KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

2- KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar, sipas listës me poshtë:

Drejtoria e Turizmit

1-Çanta cope

2-Flamuj promocional

3-Guida

4-Blllok A5 me logo

5-Poster forex

Drejtoria e Kultures, Arsimit, Rinise dhe Sportit

1-Baner

2-Kupe

Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik

1-Rool-Up

2-Canta doku

3-Stilolapsa te personalizuar

Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën dhe oren e hapjes së tenderit prane Zyres se Protokollit Bashkia Shkoder, ato duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur. Së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqesuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikim.

Shënim: Në lidhje me mostrat e kërkuara, nuk është e domosdoshme që të bëhen me logon e Bashkise Shkoder por pranohen edhe me një logo tjetër të çfarëdoshme.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro